

FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

Programi 06370: Furnizimi me ujë

HYRJE	2
1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT 06370	2
2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT	9
3. PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT	10
4. TË DHËNA MBI PROGRAMIN	11
5. PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR PBA 2024-2026	12

HYRJE

1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 06370

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Kodi i Programit	Emri i Programit	Përshkrimi i Programit
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	<ul style="list-style-type: none">• Administrim, mbikëqyrje, inspektim, vënie në funksionim ose mbështetje e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza;• Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza.• Administrim i problemeve të furnizimit me ujë;• Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë;• Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë;• Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë;• Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë.

I. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura

Shërbimi realizohet nga ndërmarrja SHRUKSH sh.a:

- Rreth 23,604 familje janë të lidhur me rrjetin KUZ në Shkodër qytet + Nj.A 3,331 biznese në të gjithë Bashkinë janë të lidhura në sistemin e KUZ;
- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza në qytet është rreth 150 km;
- Rreth 80 % e numrit të përgjithshëm të banorëve të qytetit Shkodër janë të lidhur me rrjetin KUZ. Kryesisht janë të pa lidhur me rrjetin KUZ zonat periferike të qytetit, të cilat funksionojnë me gropa septike
- Në Bashkinë Shkodër ka 2 impiante të pastrimit të ujërave të zeza: në Velipojë, dhe në Shirokë;
- Stacioni i Shirokës bën të mundur trajtimin e ujërave të përdorura që grumbullohen nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza të zonës turistike Shirokë dhe i shkarkon në liqen, duke eliminuar kështu ndotjen e liqenit.
- Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza të qytetit, i cili përbëhet prej rreth 150 km tubacione të dimensioneve të ndryshme, me material betoni dhe plastik, dhe rreth 10 000 puseta.
- Stacioni i pompave, i cili ndodhet në hyrje të qytetit (Pazar) i cili është rikonstruktuar. Ky stacion bën të mundur pompimin e ujërave të zeza dhe ngritjen e tyre në kuotën e kolektorit shkarkues. Nëpërmjet këtij kolektori shkarkues, me tubacion betoni Ø 1000 mm ujërat e zeza derdhen në lumin Drin.
- Pika e shkarkimit të ujërave të zeza , ndodhet në krah të djathtë të hyrjes së urës së Bahçallekut, në lumin Drin. Krahas saj shkarkim tjetër (emergjence) i ujërave të zeza bëhet në lumin Buna, nëpërmjet një kanali me tubacion plastik Ø 800 mm, i cili është rikonstruktuar plotësisht. Ky kanal fillon nga stacioni i pompave për në lumin Buna pranë urës së vjetër.
- Në kuadër të investimeve të realizuar nga Bashkia në programin e investimeve të vitit 2022, si pjesë e investimit në infrastrukturë është kryer rikonstruksioni i rrjetit të KUZ, nëpërmjet rehabilitimit të linjave të largimit të ujërave të ndotura, nëpër të gjitha rrugicat ku Bashkia Shkodër ka ndërhyre me shtrim të rrugëve me shtresa asfaltike.

II. Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara.

Ky shërbim realizohet nga SHRUKSH, sh.a:

- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha i qytetit të Shkodrës (për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut) funksionon i ndarë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza;
- Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve të KUB për qytetin është rreth 54 km. Rreth 37 km përbëhen nga tubacione të mbyllura dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura;
- Sistemi kryesor i drenazhimit mbulon rreth 70% të zonave formale të qytetit, ndërsa në zonat informale zë një mbulim shumë më të ulët.
- Gjatë vitit 2023 është punuar në të gjitha rrugët kryesore, si më poshte:
- Bulevardi Bujar Bishanaku, Bul. Skenderbeu , rreth 4 here.
- Bulevardi Zogu i I, rruga e Pazarit, Rruga Agron, 3 here
- Rruga Qemal dracini deri tek sheshi te Teatri dhe ne Rus.

- Unaza perendimore, në rrugët Ibrahim Rugova, Hysen Lacej, Adem Jashari, Vllezërit Frashëri, Dasho shkrelu etj, duke ndërhyre 3 here.
- Unaza Lindore ne rrugët Marie shllaku, Pal Engjelli, Gjon Buzuku, Rruga Tepe, Rruga Dracin.
- Rruga nga sheshi Perash deri tek Rotonda te argenti, 2 here.
- Rruga Nazmi Kryeziu, ku pervec pastrimit eshte bere zevendesimi i kapakeve te pusetave te demtuara.
- Rruga Hoxha Tasim, kanal i hapur ne Kiras, ne rrugen e Bujqeve dhe ne zooteknike ne rrugen Karvanej.
- Rruga Myzafer Pipa te Cinari dhe Rrugen Faik Konica.
- Ne rruget e brendshme ne Dergut shkolla Azem Hajdari.
- Ne rruget Banja e Vogel, Arkitekt Sinanni dhe rrugicat pekatese.
- Rruga 6 Maji, Qafes poshte kalase rreth 4 here.
- Ne rrugen Mar Lula me rrugicat, Rrugen Ded Gjo Luli me rrugicat.
- Rruga e Ajasmes te xhamia e Plumbit
- Rruga Levizja e Postribes, Inxh Gjovalin Gjadri me rrugicat.
- Rruga Lin Delija, Pogej,
- Dr. Ali Spahija me te gjitha rrugicat
- Eshte pastruar kanali i madh i hapur ne rrugen e Tepes dhe kanali i madhe ne drejtim te Argentit.
- Jane zevendesuar me shume se 30 kapake pusetaash te demtuara, ose te vjedhura.

III. Furnizimi me ujë të pishëm realizohet nga SHRUKSH, sh.a: Më poshtë jepet informacion mbi shërbimin që ofrojmë në qytet dhe në njësitë administrative.

- 29,729 familje (84% në Shkodër qytet + Nj.A) furnizohen me ujë të pijshëm;
- 3,334 biznese në të gjithë Bashkinë furnizohen më ujë nga ujësjellësi;
- Gjatë stinës së dimrit, sasia e prodhuar e ujit është 650 litra/ sek kurse gjatë stinës së verës, sasia e prodhuar e ujit është 850 litra/sek;
- Rreth 84% e banorëve të qytetit Shkodër dhe 24% e banorëve të Nj.A furnizohen me ujë të pijshëm;
- Furnizimi me ujë i qytetit të Shkodrës kryhet me ngritje mekanike nga 10 pusshpimet që janë në funksion dhe nga 1 stacion pompimi që ndodhen në Dobraq dhe 1 në Bahçallëk.
- Një pjesë e Njësisë Administrative Rrethina që merr furnizim me ujë nga linjat kryesore të transmetimit të ujit që shtrihen nga Stacioni Pompave në Dobraq direkt për në sistemin shpërndarës.
- Lagjen Bahçallëk me një pjesë të Njësisë Administrative Bërdicë (zona e Harkut të Bërdicës)

- Norma standarte e furnizimit me ujë është 150 litër/për një frymë/në dit. Prodhimi në stinën e dimrit është rreth 650 l/s, ndërsa në stinën e verës shkon rreth 850 l/s.
- Niveli i humbjeve të ujit është i lartë dhe është rrjedhojë e amortizimit të rrjetit, dëmtimet nga ndërtimet, ndërhyrjet e shumta të paligjshme nga banorët e ish Komunës Rrethina në linjat kryesore, zgjatja e tyre nëpër zona të banuara që arrijnë deri në Vrakë, etj. Zgjatja pa kriter të linjave të hapura private në zonat periferike shkakton prishjen e rregjimit të furnizimit me ujë të qytetit me presionin normal. Nga presioni i ulët, klientët detyrohen të instalojnë elektropompa individuale për ngritjen e ujit në katet e sipërme të objekteve duke rritur koston për m³ të ujit të prodhuar.
- Nevojat për ndërhyrje me investime për përmirësimin e sistemit ujësjellës janë shumë të mëdha si në rrjetin shpërndarës të qytetit, ashtu edhe në ndërtimin e rrjetit për zonat informale, zonat rurale dhe në linjat kryesore.

Aftësia financiare e SHRUKSH sh.a nuk është e mjaftueshme për realizimin e investimeve kapitale në sektorin e ujësjellësit, por me mbështetjen e Bashkisë Shkodër është synuar përmirësimi i shërbimit, nëpërmjet rehabilitimit të linjave të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura, nëpër të gjitha rrugicat ku Bashkia Shkodër ka ndërhyrje me shtrim të rrugëve me shtrea asfaltike.

Sfidat:

Nevojat për ndërhyrje me investime për përmirësimin e sistemit ujësjellës janë shumë të mëdha si në rrjetin shpërndarës të qytetit, ashtu edhe në ndërtimin e rrjetit për zonat informale, zonat rurale dhe në linjat kryesore.

- **Me fondet e vetë Bashkisë:** Rikonstruksion e rrjetit kryesor të ujësjellësit dhe ndërtim i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit në fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Vinoteka dhe Fshat i Ri (Pularia), Hot i Ri, Grudë e Re (faza e dytë dhe e tretë).

Njëkohësisht në çdo investim që realizohet me fondin e investimit në programin e përmirësimit të infrastrukturës së rrugëve, pjesë përbërëse e këtyre investimeve është edhe rikonstruksioni i plotë, ose ndërtimi (kur mungon tërësisht) i rrjetit të ujit të pijshëm.

- **Këshilli i Qarkut në bashkëpunim me qeverinë Shqiptare:** Ndërtim i Ujësjellësit në fshatin Muriqan, Bashkia Shkodër. Në këtë kuader Ndërtimi i Ujësjellësit në fshatin Muriqan, si pjesë e Bashkisë Shkodër në Njësinë Administrative Ana e Malit, Qarkut Shkodër konsiderohet një ndër prioritetet e Bashkisë Shkodër për përmirësimin e jetës në komunitet. Zona e cila është parashikuar të përfitojë nga Ndërtimi i Ujësjellësit në fshatin Muriqan, Bashkia Shkodër ndodhet rreth 16 km larg nga qyteti i Shkodrës dhe nga ky investim përfiton një komunitet prej 1000 banorësh. Përmes këtij investimi, synohet që të ndryshohet jetesa banoreve, do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik-social të zonës.

- **Me fondet e donatorëve:** Programi i performancës dhe investimeve në sektorin Ujësjellës – Kanalizime, me bashkëpunim financiar të qeverisë Gjermane, Bashkimit Europian dhe SECO. Ky projekt do të financojë për një periudhë afatmesme:

A. Rrjet të ri të ujit të pijshëm:

1. Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive me rrjetin në zonën Dobraq duke përfshirë edhe lagjen Golem. Theksojmë se banorët e zonës së Dobraqit kanë marrë ujë të pijshëm në tubacionet e dergimit nga qyteti i Shkodrës, duke e dëmtuar nga ndërhyrjet e paligjshme. Kjo zonë paraqet rreth 30-40 % të humbjeve në rrjet.
2. Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive me rrjetin në lagjen Mark Lulaj, zona nga Fermentimi që shtrihet pas shinave të trenit deri në Tepe.
3. Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive me rrjetin në zona e Livadeve, duke përfshirë edhe lagjen Kiras

B. Rrjet të ri të kanalizimeve të ujërave të zeza

1. Zona Dobraq përfshirë lagjen Golem
2. Lagja “Mark Lulaj” që shtrihet pas shinave të trenit deri në Tepe
3. Zona e Livadeve përfshirë lagjen Kiras
4. Ndërtimi i impiantit të ujërave të ndotura për qytetin e Shkodrës, në Zues
5. Përfshirja e lagjes Bahçallek për shkarkimin e ujërave të zeza në kolektorin e qytetit
6. Rikonstruksioni i stacionit dhe linjat e dergimit KESON.

Tabela 1 Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

PBA 2024-2026							
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike						
Bashkia Shkoder	Institucioni-						
Programi	6370	Furnizimi me ujë					
Burim financimi : Transferte e pakushtezuar , Transferte sektoriale , Ardhurat e veta dhe Donator							
Shpenzimet e Programit (000 ALL)							
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2021	2022	2023	2024	2025	2026
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest I miratuar VKB 71 dt 27.12.2022	Plani	Plani	Plani
Paga dhe Sigurime							
Paga	600	0	0	0	0	0	0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	0	0	0	0	0	0
Korente							
Mallra dhe Shërbime	602	0	0	0	0	0	0
Subvencion	603	0	0	0	0	0	0
Transferta të Brendshme	604	13,998	15,000	15,000	15,000	15,000	15,000
Transferta të Jashtme	605	0	0	0	0	0	0
Transferta për Familje & Individë	606	0	0	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale							
Aktive të Paprekshme	230	0	0	0	0	0	0
Aktive të Prekshme	231	9,016	16,924	22,027	0	0	0
TOTALI		23,014	31,924	37,027	15,000	15,000	15,000

Komente

Programi 6370: Furnizimi me uje dhe kanalizime, ka si burim financimi burimet e veta. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat për investimin e furnizimit me ujë për komunitetin.

Shpenzimet korrente zënë 100% të shpenzimeve për vitin 2024, 2025 dhe 2026.

2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

POLITIKA E PROGRAMIT					
Programi Buxhetor Afatmesëm		2024-2026			
Programi	6370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime			
Përshkrimi i Programit					
<ul style="list-style-type: none"> • Administrim i problemeve të furnizimit me ujë; • Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, crnimin dhe kontrollet e sasisë; • Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë; • Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë; • Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë. • Administrim, mbikëqyrje, inspektim, vënie në funksionim ose mbështetje e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza; • Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza. 					
1	Qëllimi i Politikës së Programit	<p>Q1. I.Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. II.Rritja e efijencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit. III.Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe të monitorimit për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre . IV.Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmblytjet në zonat e banuara;</p>			
	Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	2023	2024	2025	2026
		Buxheti	Plani	Plani	Plani
	Rritja e efijencës buxhetore në ofrimin e shërbimit të kanalizimeve të ujërave të shiut - ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës	0%	0%	0%	0%
1.2.	Objektivi i Politikës së Programit	Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë.			
	Treguesit e Performancës për Objektivin				
	Rritja e efijencës buxhetore në ofrimin e shërbimit të kanalizimeve të ujërave të shiut - ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës	0%	0%	0%	0%

3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Tabela 2 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT				
Programi Buxhetor Afatmesëm		2024-2026		
Programi	06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime		
1.1.	Objektivi i Politikës së Programit	Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut në të gjithë zonat urbane të Nj.A të bashkisë.		
1.1.A.	Produkti	Menaxhimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut (KUB)		
	<i>Kodi i Projektit</i>	P06370.Q1.O1.A1		
	Përshkrimi i Produktit:	Mirëmbajtje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme e rrjetit të kanalizimit të ujërave të bardha për zonën e Bashkisë Shkodër. Evitim i problematikave që mund të çojnë në përmytje të zonave të caktuara.		
	Njësia Matëse	numri i popullsisë me shërbime sanitare		
		2023	2024	2025
		Buxheti	Plani	Plani
	Sasia	98,050	100,137	104,309
	Kosto totale (në mijë lekë)	15,000	15,000	15,000
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.2	0.1	0.1
	Ndryshimi në % i Sasisë		2.1%	4.2%
	Ndryshimi në % i kostos totale		0.0%	0.0%
	Ndryshimi në % i kostos për njësi		-2.1%	-4.0%
				-3.8%

4. Të Dhëna mbi Programin Error! Bookmark not defined.

Tabela 3. Të dhënat e Programit

Të Dhëna Bazë mbi Programin									
Programi 6370	Të Përgjithshme	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Të dhënat e programit/ Vitet									
Të ardhurat e realizuara (në mijë lekë) nga tarifa e shërbimit të kanalizimeve		51,855	50,937	66,536	103,084	98,112	99,070	101,861	104,652
Të ardhurat e planifikuara (në mijë lekë) nga tarifa e shërbimit të kanalizimeve		54,228	53,493	53,224	74,292	98,112	99,070	101,861	104,652
Buxheti për shërbimin e menaxhimit të ujërave të zeza dhe kanalizimeve		83,592	81,366	79,346	93,494	93,861	95,112	107,160	119,208
<i>Shpenzime operative kanalizime (në mijë lekë)</i>		54,542	54,051	48,480	62,641	62,887	63,725	65,512	67,299
<i>Shpenzime operative impiantet e përpunimit (në mijë lekë)</i>		29,050	27,315	30,867	30,853	30,974	31,387	41,648	51,909
Sasia e ujit të shkarkuar me sistemin e përpunimit të ujërave të ndotur		400,896	450,000	322,127	450,000	450,000	450,000	450,000	450,000
Popullsia që mbulohet nga shërbimi i trajtimit të ujërave të zeza/ndotura		51,200	51,200	10,830	51,200	51,200	51,200	51,200	51,200
Popullsia me shërbime sanitare / kanalizimeve të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha)		88,880	93,939	93,310	102,131	98,050	100,137	104,309	108,481
Popullsia në zonën e shërbimit		208,618	209,542	208,618	210,182	210,182	210,182	210,182	210,182
Buxheti për shërbimin e menaxhimit të kanalizimeve të ujërave të shiut		15,640	14,710	13,998	15,000	15,000	15,000	15,000	15,000

5. Projektet e planifikuara për PBA 2024-2026 Error! Bookmark not defined.

Tabela 4 Emërtimet e aktiviteve

Produktet	Aktivitete/Projekte	Institucioni	PROGRAMI BUXHETOR AFATMEËM 2024-2026		
			Totali		
			2024	2025	2026
			Totali	Totali	Totali
Menaxhimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të shiut (KUB) (numër popullsisë me shërbime sanitare)	P06370.Q2.O2.A1. Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB)	Bashkia Shkodër	15,000	15,000	15,000
	Totali 6370 Furnizimi me uje dhe kanalizime		15,000	15,000	15,000

<p>Nr.1</p>	<p>P06370.Q1.O1.A1 Menaxhimi i sistemit të ujërave të bardha (KUB)</p>	<p>Funksioni 5: Mbrojtja e mjedisit N/Funksioni 063: Furnizimi me ujë Llojet e programit: 06370: Furnizimi me ujë</p>
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</p>		
<p>i. Situata</p>		
<p>Gjendja aktuale e sistemi i kanalizimit të ujërave të bardha (KUB): Sistemi i kanalizimit të ujërave të bardha (shiu), u ndërtua fillimisht si një sistem i veçantë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të përdorura. Shkodra ka një sistem largimi të ujërave të shiut sipas një sistemi kanalesh të hapura, tombino dhe tubacione ku pjesa më e madhe e ujit të shiut shkarkohet me gravitet në Liqenin e Shkodrës. Disa zona, duke përfshirë edhe zonën industriale, shkarkohen në lumin Kir.</p> <p>Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve për qytetin e Shkodrës është rreth 54 km, nga të cilat, rreth 37 km përbëhet nga tubacione të mbyllura betoni e plastike dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura. Kanalet e hapura kanë nevojë për pastrime të herëpashershme, për të siguruar një gjendje të mirë të tyre nga ana hidraulike. Për të ardhmen duhet të mendohet investimi në mbulimin e tyre, pasi gjendja aktuale e tyre është burim hedhjeje e mbeturina inerte dhe të llojeve të tjera nga persona të papërgjegjshëm, duke u shndërruar në rrezik shëndetësor për komunitetet përreth tyre. Pjesa tjetër e kanalizimeve përbëhet nga kanale në gjendje të amortizuar, me karakteristika përcjelljeje prurje jo të mira. Përveç kësaj, ka dhe shumë kilometra me kanale të vogla kullimi, të cilat kanë nevojë për ridimensionim.</p> <p>Problematikë tjetër e mprehtë, janë lidhjet e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të përdorura me kanalizimet e ujërave të shiut, që janë bërë ndër vite si rrjedhojë e mungesës së rrjeteve të kanalizimit, apo në mënyrë të njëanshme nga banorët. Këto lidhje, përbëjnë rrezik të dukshëm, sidomos nga përmbytjet gjatë kohës së reshjeve. Vjedhja e kapakëve të pusetave dhe gradelave prej material gize, krijon probleme në qarkullim dhe shoqërohet me hedhje të mbeturinave të cilat çojnë në bllokim dhe mosfunksionim të tyre.</p> <p>Puna e deritanishme tregon për probleme të shumta dhe për nevoja emergjente ndërhyrjeje edhe në sektorin e KUB për zonat rurale.</p> <p>Aktiviteti punues i sektorit KUB për vitin 2023 Për vitin 2023 janë hartuar plane pune për mirëmbajtjen rutinë të pastrimit të kanaleve të ujërave të shiut, gjithashtu janë realizuar edhe ndërhyrje të paplanifikuara sipas situatave kritike që janë krijuar dhe që rrezikonin përmbytje të zonave të caktuara. Kanalet kryesore të kullimit kanë nevojë për ndërhyrje në pastrimin e tyre me makineri të mëdha, për heqjen e dherave, largimin e mbeturinave dhe prerjen e shkurreve dhe bimësisë përgjatë tyre.</p> <p>Gjatë vitit 2023 është punuar në të gjitha rruget kryesore, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Unaza perendimore, në rrugët Ibrahim Rugova, Hysen Lacey, Adem Jashari, Vllezërit Frashëri, Dasho shkrelli etj, duke ndërhyrë 3 here. • Unaza Lindore ne rrugët Marie shllaku, Pal Engjelli, Gjon Buzuku, Rruga Tepe, Rruga Dracin. • Rruga nga sheshi Perash deri tek Rotonda te argenti, 2 here. • Bulevardi Bujar Bishanaku, Bul. Skenderbeu , rreth 4 here. • Bulevardi Zogu i I, rruga e Pazarit, Rruga Agron, 3 here • Rruga Qemal dracini deri tek sheshi te Teatri dhe ne Rus. • Rruga Nazmi Kryeziu, ku pervec pastrimit eshte bere zevendesimi i 9 kapakeve te pusetave te demtuara. • Rruga Hoxha Tasim, kanal i hapur ne Kiras, ne rrugen e Bujqeve dhe ne zooteknike ne rrugen Karvanej. • Rruga Myzafer Pipa te Cinari dhe Rrugen Faik Konica. • Ne rruget e brendshme ne Dergut shkolla Azem Hajdari. • Ne rruget Banja e Vogel, Arkitekt Sinanni dhe rrugicat pekatese. • Rruga 6 Maji, Qafes poshte kalase rreth 4 here. • Ne rrugen Mar Lula me rrugicat, Rrugen Ded Gjo Luli me rrugicat. • Rruga e Ajasmes te xhamia e Plumbit • Rruga Levizja e Postribes, Inxh Gjovalin Gjadri me rrugicat. • Rruga Lin Delija, Pogej, Dr. Ali Spahijame te gjitha rrugicat • Eshte pastruar kanali i madh i hapur ne rrugen e Tepes dhe kanali i madhe ne drejtim te Argentit. • Jane zevendesuar me shume se 30 kapake pusetash te demtuara, ose te vjedhura. <p>Gjatë vitit 2023, janë realizuar ndërhyrje ne rruget kryesore te qytetit, te cilat kane bere te mundur kullimin e sasive te reshjeve te cilat ishin pertej kapacitetit teknik te tyre. Bashkia Shkodër ka investuar shumë në rikonstruksion të rrjetit KUB, jo vetëm në rrugët e qytetit të Shkodrës, por është në zonat rurale.</p> <p>Përveç kanaleve të mëdha kulluese, gjithashtu ka vazhduar puna rutinë në pastrimin e kunetave dhe kanaleve në rrugica të lagjeve të ndryshme të qytetit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Riparime dhe vendosje gradelash dhe puseta • Meremetim puseta Unaza e madhe • Zëvendësimin e gradelave dhe riparim puseta të demtuara në të gjithë qytetin. • Punime civile: • Pastrim territori Ambjente e SHRUKSH sh.a, Stacionet e pompimit, Kaptazhet dhe rezervuaret. <p>Kostot e aktivitetit punues të sektorit KUB Zërat kryesore të kostos për sektorin e KUB, paraqiten si më poshtë: Përsa i përket pagave dhe sigurimeve shoqërore, llogaritjet për fondin e pagave, janë bërë mbi bazën e organikës së</p>		

miratuar për vitin 2023 për sektorin e KUB dhe nivelit të pagës së përcaktuar, nga Këshilli i Administrimit i SHRUKSH sh.a. Nevojat për bazë materiale, janë gjithashtu të larta dhe grupet kryesore të artikujve për mbulimin me këtë shërbim të të gjithë zonës së shërbimit, janë si më poshtë:

1. Kapakë puseta dhe gradela
2. Naftë
3. Prodhime betoni
4. Materiale ndërtimi
5. Materiale për zyrë

Kapakë puseta dhe gradela, zë një pjesë të konsiderueshme, për arsye se përveç zëvendësimeve nga dëmtimet e tyre, duhet të bëhet mbahen në konsideratë edhe vjedhjet e shumta për këto produkte për arsye se ato tregtohen për skrap. Shqetësimi që krijon në qarkullimin e automjeteve dhe të këmbësorëve, na imponon ndërhyrjen e domosdoshme me zëvendësimin dhe vendosjen e kapakëve dhe gradela, në segmentet ku mungojnë.

Në funksion të mirëmbajtjes së rrjetit sektori i KUB ka në përdorim një mjet gërmues, një mjet transporti dhe një mjet zbllokues. Automjetet janë të rënda dhe kërkojnë konsum të madh naftë, pasi ato konsumojnë në ecje dhe gjithashtu për orë punë, gjatë pastrimit të kanaleve të hapura të cilat mbushen jo vetëm me mbeturina, por gjithashtu edhe nga bimësia që rritet në to, duke penguar rrjedhjen e lirë të ujërave.

Prodhimet e betonit dhe materialet e ndërtimit, kryesisht përdoren për zëvendësimet e kapakëve dhe soletave b/a, që mbulojnë shume puseta në blloqe të ndryshme. Gjithashtu riparimi i puseta të dëmtuara, ka nevojë për tulla, blloqe dhe materiale ndërtimi.

Bazuar edhe në nevojat në rritje për mbulimin dhe zgjidhjen e problematikave, të sektorit të kanalizimit të ujërave të bardha, edhe për zonat që shtrihen përtej kufinjve të vijës së verdhë të qytetit, shpenzimet e KUB janë rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe në bazë të rishikimit të kërkesave për këtë sektor, vlerësohet se niveli i parashikuar i shpenzimeve për vitin 2024 të jetë 15.000.000 lekë. Gjithashtu edhe parashikimet për shpenzimet operative të sektorit KUB për vitin 2024-2026, parashikohet të jenë të jenë të larta, kjo si rrjedhojë e rritjes së volumit të punëve dhe mbajtjes në gjendje të mirë të kanaleve të kullimit për evitimin e përmblytjeve të mundshme gjatë rreshjeve atmosferike

Sektori KUB vlerësohet nga UK Shkodër Sh.a, si një sektor, sa i rëndësishëm aq edhe delikat, sidomos në problematikat që krijon në stinët e pranverës, vjeshtës dhe dimrit ku reshjet e shumta që bien në qytetin tonë, krijojnë shpeshherë probleme deri në përmblytje. Tendenca në rritje e kostove të operimit për UK Shkodër, dhe vështirësitë financiare për mbulimin e shpenzimeve operative, si rrjedhojë e zgjerimit të zonës së shërbimit dhe marrjes në dorëzim të sistemeve të KUB për zonën e Velipojës, Bërdicës, etj të cilat gjithashtu kanë problematika të mbartura nga mungesa e mirëmbajtjes, apo investimeve në pjesën më të madhe të tyre, kërkojnë angazhim dhe përpjekje në nivele akoma më të larta.

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha i qytetit të Shkodrës (për mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut) funksionon i ndarë nga rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza. Sistemi kryesor i drenazhimit mbulon rreth 70% të zonave formale të qytetit, ndërsa në zonat informale zë një mbulim shumë më të ulët.

ii. Synimi i projektit

Sigurimi i funksionimit normal të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha (shiut) në qytet dhe grykëderdhjet kryesore për të evituar problematikat e ndryshme, përfshirë edhe uljen e mundësisë së përmblytjeve të qytetit.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Mirëmbajtje e vazhdueshme e kanalizimeve të ujërave të bardha nga UK Shkodër brenda zonave nën administrim. Pastrimi i pusetave dhe gradelave shi mbajtëse, përfshirë edhe riparimin ose zëvendësimin e pusetave, kapakëve të dëmtuar ose të vjedhur. Pastrimi i kanaleve kryesore të kullimit dhe ndërhyrjet me makineri për heqjen e dherave, largimin e mbeturinave dhe prerjen e shkurreve dhe bimësisë përgjatë tyre. Ndërtimi i rrjetit të ri KUB si pjesë integrale e projekteve të programit të infrastrukturës rrugore për Buxhetin 2022 të Bashkisë Shkodër

b) Rezultatet që prisni

Mirëmbajtje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme e rrjetit të kanalizimit të ujërave të bardha për zonën e Bashkisë Shkodër. Evitim i problematikave që mund të çojnë në përmblytje të zonave të caktuara. Rritja e cilësisë dhe sigurisë së shërbimit për qytetarët e bashkisë Shkodër, si rezultat i tarifave të reja të miratuara së bashku me investimet kapitale në rrjetin KUB.

c) Aktorët e mundshëm

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastruktura, Sektori i planifikimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës. Sh.a. SHRUKSH. Drejtoria Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve.

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër Komuniteti

Shpenzimet për çdo aktivitet 2024

Totali (000 lekë)

Nga kjo:

Paga, sig

Operative

Transferi

Kapitale

					me	
A.1	Transferim për mbulimin e kostove operativedhe mirëmbajtjes (O&M) së rrjetit KUB.	15,000			15,000	
	Shuma totale	15,000			15,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga, sig	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Transferim për mbulimin e kostove operativedhe mirëmbajtjes (O&M) së rrjetit KUB.	15,000			15,000	
	Shuma totale	15,000			15,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga, sig	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Transferim për mbulimin e kostove operativedhe mirëmbajtjes (O&M) së rrjetit KUB.	15,000			15,000	
	Shuma totale	15,000			15,000	
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2024 – 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës SHRUKSH sha. Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër				